



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/137
Datë: 31.03.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 mars 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/137
Datë: 31.03.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 mars 2023, merr këtë:

V E N D I M


1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1. e Vendimit të Qeverisë Nr. 03/111 të datës 7 dhjetor 2022, i cili ndryshon dhe plotëson Vendimin e Qeverisë Nr. 10/109, të datës 23 nëntor 2022 në atë mënyrë që shfuqizohen pikat 2.3 dhe 2.6.
2. Në mungesë të bazës së mirëfilltë ligjore, shfuqizohen edhe aktet nënligjore, si në vijim:
 - 2.1. Rregullore (QRK) Nr. 09/2015 për Koordinimin e Asistencës së Donatorëve të Jashtëm në Republikën e Kosovës;
 - 2.2. Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2008 për Përdorimin e Telefonave (fiks dhe mobil) në Qeverinë e Kosovës.
3. Obligohet Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare që të publikojë shfuqizimin e akteve nënligjore sipas pikës 1. të këtij Vendimi në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Sundimi i ligjit është një nga vlerat themelore të rendit kushtetues të Republikës së Kosovës. Në këtë kontekst, parimi i ligjshmërisë së akteve nënligjore në kuptimin e ndalimit të veprimit arbitrar të të gjitha organeve të cilat mund të intervenojnë në marrëdhëniet ndërmjet subjekteve të së drejtës vetëm në bazë të autorizimeve të fituara me ligj, derivon edhe nga Seksioni II, A, 1, 2.4, i Listës së Kontrollit të Sundimit të Ligjit, të nxjerrë nga Komisioni i Venedikut, ku në mënyrë shprehimore përcaktohet obligimi i institucioneve për të vepruar në pajtueshmëri strikte me kompetencat e përcaktuara me ligj.

Miratimi i këtij vendimi me të cilin janë shfuqizuar katër (4) akte nënligjore të cilat janë vlerësuar se nuk kanë bazë të mirëfilltë ligjore, krahas edhe shfuqizimit të akteve të tjera nënligjore me Vendimin e Qeverisë Nr. 09/110, të datës 23 nëntor 2022, është në funksion të plotë të sigurimit të sundimit të ligjit, përmes sigurimit të parimit të ligjshmërisë përkatësisht sipas Seksionit II, A, 1, 2, 4, 7 të Listës së Kontrollit të Sundimit të Ligjit dhe parimit të sigurisë juridike sipas Seksionit II, B, 1, 3, 4, 5 të së njëjtës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/137
Datë: 31.03.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 mars 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr. 01/23, i datës 8 prill 2020.
2. Fshihet pika 6 e Vendimit.
3. Pas pikës 5 shtohen pikat 6, 7, 8, 9 dhe 10 me përmbajtjen, si në vijim:
 6. Pajisja me telefona për nëpunësit civil realizohet pas plotësimit të formularit në Shtojcën 1. të këtij Vendimi, të nënshkruar nga drejtori i departamentit dhe të miratuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ i institucionit përkatës. Instalimi realizohet vetëm nga punonjësit e departamentit të teknologjisë informative ("DTI") apo nga pala e kontraktuar, nën mbikëqyrjen e DTI-së.
 7. Obligohet DTI në Ministrinë e Punëve të Brendshme për mirëmbajtjen e rrjetit telefonik fiks në Qeverinë e Kosovës.
 8. Obligohet Zyrtari Kryesor Administrativ i institucionit që më së largu deri me datën 10 të muajit vijues, t'i paraqes raport Ministrin/Kryeministrit dhe një kopje t'ia përcjell DTI-së, lidhur me shpenzimet telefonike të institucionit për muajin paraprak. Ky raport përcillet nga DTI në Qeveri deri me datën 15 të muajit vijues.
 9. Për nevojën e tejkalimit të shumës mujore të përcaktuar me Vendimin Nr. 01/23 të datës 8 prill 2020, parashtrohet kërkesë e arsyetuar për aprovim të veçantë nga Zyrtari Kryesor Administrativ i institucionit dhe miratim nga Ministri/Kryeministri.
 10. Telefonat zyrtarë të Qeverisë përdoren vetëm për biseda zyrtare, përmes numrave centrex sipas udhëzuesit të DTI-së. Tejkalimi i paautorizuar i shpenzimeve të lejuara, mbulohet nga nëpunësi i cili ka tejkaluar shumën.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/137
Datë: 31.03.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 mars 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Programi Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE) 2023 – 2027.
2. Buxheti për zbatimin e këtij Programi është brenda ndarjeve buxhetore të organizatave buxhetore për vitin 2023 dhe në pajtim me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2023-2025.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit që të adresojë komentet e Komisionit Evropian deri në miratimin përfundimtar të Programit dhe gjatë zbatimit të tij.
4. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet e tjera përgjegjëse, sipas Programit, që të zbatojnë këtë Vendim.
5. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Programin nga pika 1. e këtij Vendimi të i'a dërgoj Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë